

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **625-26-2637-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	D.P.Z.,,Naimi"
NUI	600414320
Adresa	MALISHEVË
Vendi	MALISHEVË
Kodi postar	24000
Numri Telefonit	+38349717441
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	HAKI HOXHA
Adresa elektronike	haki.hoxha12@outlook.com
Data e parashtrimit të ankesës	06.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

Autoriteti Kontraktues më datë: 24.04.2026, ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit për procedurën: SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS, me nr: 2026/625-26-2637-2-1-1.

Me datë: 13.05.2026, ne kemi dorëzuar ofertat.

Me datë: 26.05.2026, AK ka publikuar Njoftim Vendimin e AK dhe Letrat Standarde.

Në bazë të vendimit të datës: 26.05.2026, AK ka rekomanduar për Kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik IDEALI & GETI SH.P.K.; AUTOBUQA SH.P.K., Ismet Krasniqi pn., 24000, Malishevë, Kosovë.

Ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dhe po ashtu pas refuzimit të AK, kemi bërë ankesë në OSHP, ku OSHP ka konstatuar shkeljet ligjore të bëra nga AK dhe me vendim nr.0371/2026 të datës: 29.06.2026 dhe ka detyruar AK që lëndën të kthejë në RIVLERËSIM.

AK gjatë RIVLERËSIMIT me datë 21.07.2026 ka publikuar Njoftim Vendimin e AK, por tash ka anuluar aktivitetin e prokurimit, në mungesë të OE të përgjegjshëm, ndërsa ofertën tonë e ka vlersuar si ofertë që kemi tejkaluar vlerën e parashikuar

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Me datë: 27.07.2026 Kemi paraqitë kërkesën për rishqyrtim

Më datë: 29.07.2026, AK na ka refuzuar kërkesën

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK:

Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues më datë: 24.04.2026, ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit për procedurën: **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**, me nr: 2026/625-26-2637-2-1-1.

Me datë: 13.05.2026, ne kemi dorëzuar ofertat.

Me datë: 26.05.2026, AK ka publikuar Njoftim Vendimin e AK dhe Letrat Standarde.

Në bazë të vendimit të datës: 26.05.2026, AK ka rekomanduar për Kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik IDEALI & GETI SH.P.K.; AUTOBUQA SH.P.K., Ismet Krasniqi pn., 24000, Malishevë, Kosovë.

Ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dhe po ashtu pas refuzimit të AK, kemi bërë ankesë në OSHP, ku OSHP ka konstatuar shkeljet ligjore të bëra nga AK dhe me vendim nr.0371/2026 të datës: 29.06.2026 dhe ka detyruar AK që lëndën të kthejë në RIVLERËSIM.

AK gjatë RIVLERËSIMIT me datë 21.07.2026 ka publikuar Njoftim Vendimin e AK, por tash ka anuluar aktivitetin e prokurimit, në mungesë të OE të përgjegjshëm, ndërsa ofertën tonë e ka vlersuar si ofertë që kemi tejkaluar vlerën e parashikuar:



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



B42 - Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar³

21.07.2026 MALISHEVË

- Grup i Operatorëve Ekonomik D.P.Z., Naimi ; KRASNIQI SERVICE SH.P.K., MALISHEVË, 24000, MALISHEVË

Titulli: SËRVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr. i Prokurimit:	62500	2	6	2	6	3	7	2	1	1
-------------------	-------	---	---	---	---	---	---	---	---	---

I/e ndëruar(a) [Z/Znj]: - Grup i Operatorëve Ekonomik D.P.Z., Naimi ; KRASNIQI SERVICE SH.P.K., MALISHEVË, 24000, MALISHEVË

Falënderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP [Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me qëqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm: ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye: Ju eliminoheni për arsye se:

GE: ka tejkaluar vlerën e parashikuar nga AK. Vlera e parashikuar ka qenë 148,000.00€ ndërsa Gr.i OE ka ofertuar çmimi për njësi 161,980.50€.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Data: 21.07.2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Besnik Krasniqi

³ Kjo letër u dërgoi të tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderit e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme nga ana tona si pa përgjegjshëm dhe si pa kualitet (Shih letër njoftuese sipas nevojës).

SHKELJET E KONSTATUARA

1. Mosrespektimi i Vendimit të OSHP-së nr.0371/2026 të datës: 29.06.2026. OSHP me këtë vendim ka konstatuar se AK nuk ka vlerësuar në përputhje me nenin 59 të LPP-së, kur ka rekomanduar OE I cili ka ndërhyrë në paramasë.
2. AK me vendimin e datës: 21.07.2026, ka ANULUAR aktivitetin e prokurimit, ku për OE të cilin e kishte rekomanduar për kontratë ka zbatuar Vendimin e OSHP-së dhe ka konstatuar shkeljet gjatë fazës së RIVLERËSIMIT dhe e ka vlerësuar si të pa përgjegjshëm sepse I njëjti ka ndërhyrë në paramasë.
3. Ndërsa në pamundësi për të rekomanduar OE të cilin e kishte rekomanduar më herët, ofertën tonë e ka vlerësuar si ofertë që ka rejkualuar buxhetin e planifikuar dhe e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, edhe pse kjo procedure është kontrate publike kornize me çmime per njësi, dhe vlera e parashikuar është vlera per te

cilen do te lidhet kontrata !.

Pra AK me date: 21.07.2026, na ka derguar njoftimin per eleminim duke e aresyetuar eliminimin tone nga kjo procedure per shkak te tejkalimit te vleres se parashikuar te kontrates !!!.

Procedura e prokurimit eshte kontrate **me cmime per njesi**, ku vet AK I ka ndarë shërbimet në dy kategori:

	<u>Rikapitullim i Përgjithshëm</u>	<u>Pesha e Çmimit sipas rëndësisë</u>	<u>Çmimi per njesi i ofertës me TVSH në €</u>
	<u>Pershkrimi</u>		
A	<u>Çmimi për servise te rregullt</u>	60%	0.00 €
B	<u>Çmimi për mirëmbajtje dhe pjesë reserve</u>	40%	0.00 €
	<u>Totali i Përgjithshëm</u>	100%	0.00 €

Kete kategorizim AK e ka vendosur edhe ne përshkrimin e çmimeve duke e specifikuar pëshën e secilës kategori.

Vlera e parashikuar e kontrates per kete procedure eshte: 148,000.00 euro.

Ne kemi ofertuar për te gjitha pjeset/sherbimet e kerkuar nga AK dhe per te gjitha veturat qe AK ka vendosur ne listen e pershkrimit te cmimeve. Eshte normale qe totali i te gjitha pjeseve, sherbimeve per te gjitha veturat te jete mbi kete vlere, sepse ne praktik nuk do te ndodhe qe per secilen vetur te ndrrohet secila pjese dhe te kryhen sherbimet, sepse pikerishte per kete qeshtje AK ka udhehequr kete lloje te procedures.

Ne baze te rregullores se prokurimit publik 001/2022, neni 54.15 e ka percaktuar qe per kontrata me cmime per njesi siq eshte ky aktivitet i prokurimit, vlera e parashikuar nuk duhet te tejkalohet gjate realizimit te kontrates, ndersa ne rastin e njesive (te gjitha sidomos te servisimi i veturave kemi te bejme me vendosjen e cmimeve per njesi per te gjitha pjeset, per te gjitha veturat qe eshte normale qe totali te del mbi kete vlere (148,000.00euro):

54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të

ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje).

Pra cmimi i ofertuar për njësi me peshim, është vetëm për qëllime vlerësimi dhe kontrata lidhet me vlerën e parashikuar.

Është shkelje e LPP-se nëse themi ka tejkalim të vlerës së parashikuar.

Ne vlerësojmë që AK ka bërë shkelje të LPP-se dhe rregullores së prokurimit nr.001/2022 sepse në këto raste nuk kemi të bëjmë fare me tejkalim të vlerës së parashikuar, për më tepër çmimet për njësi të vendosura nga ana e jone janë çmime të tregut dhe kontrata do të mund të perfundojë kur AK arrijë vlerën e parashikuar prej 148,000.00 euro, siq është përcaktuar me Rregulloren për prokurim publik 001/2022.

Një pretendim të tillë ne e kemi pas me një Autoritet tjetër Kontrates dhe OSHP e ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar. Për këtë qështje e kemi informuar AK në kërkesën për rishqyrtim të cilën e kemi dorëzuar në AK, por I njëjti nuk ka marrë parasysh vendimin e OSHP-së dhe ka vepruar në kundërshtim me LPP-në, RRPP-në nr.001/2022 dhe Vendimet e OSHP-së.

Te bashkangjitur shikojeni të njëtin pretendim të cilin e kemi fituar në ankesën nr. **OSHP: 2023/0691 PSH. nr. 691/23 të datës: 15.12.2023.**

Kërkojmë nga OSHP të aprovojë ANKESËN tonë, të detyrojë AK që ta kthejë Lëndën në RIVLERESIM dhe të na propozojë ne për fitues të këtij projekti si OE i përgjegjshëm me çmimin me të lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e supozuar ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e dëmeve materiale për kompaninë tonë, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe duke sjellë elemente të diskriminimit në këtë procedurë. Si pasojë, ne jemi të detyruar të përballojmë kosto shtesë, përfshirë shpenzimet administrative dhe financiare që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurës së ankesës. Këto kosto shtesë për rishqyrtim të vendimit në AK përfaqësojnë barrë të panevojshme për operatorin ekonomik dhe dëmtojnë pozitën tonë konkurruese në treg.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*